

Temperatura e lartë tek fëmija



Flasim për temperaturë kur ajo është mbi 38°C.

Çfarë është temperatura e lartë dhe cilat janë rreziqet?

Temperature është :

- E dobishme, është reagim normal i organizmit për ta ndihmuar atë të luftojë kundër infeksioneve
- Shpesh është e pranishme gjatë sëmundjeve të parëndësishme si ftohja e zakonshme
- Pa ndonjë të keqe, rrallë është shenjë e një sëmundjeje të rëndë

Në shumicën e rasteve, ajo zhduket pa pasur nevojë të jepni ndonjë mjekim.

Si të matni temperaturën e fëmijës suaj ?

Ka disa mënyra për matjen e temperaturës dhe secila prej tyre ka epërsitë dhe mangësitë e veta. Prandaj është e rëndësishme të vlerësoni se çfarë është më e përshtatshme për fëmijën tuaj në varësi të moshës dhe të ndonjë sëmundjeje të veçantë. Nuk rekomandohet më marrja e temperaturës rektale për të shmangur dëmtimin e fëmijës.

Kur duhet trajtuar temperatura e lartë ?

Është e rëndësishme të vlerësoni gjendjen e përgjithshme të fëmijës suaj, që do të përcaktojë trajtimin dhe shpejtësinë e një konsultimi :

- Irritimi
- Të qara të pandërprera
- Rënia e aktivitetit dhe/ose e aftësisë për të reaguar
- Humbja e oreksit
- Çrregullime të gjumit për shembull

Mosha	Tipi i marrjes	Epërsitë	Kufizimet	Metoda
Më pak se 4 javë	nën sqetull	Shpejt, pa rrezik dëmtimi	Kushtojni vëmendje sa i besueshëm është termometri	Termometri duhet jetë në kontakt me lëkurë të tharë
Më shumë se 4 javë	Nën sqetull edhe në vesh	Matje e shpejtë dhe e besueshme	Marrja e temperaturës në timpanin e veshit kërkon një kanal të pastër të tij.	Veshi duhet të tërhiqet nga mbrapa në mënyrë që të hapet plotësisht kanali i veshit



Te fëmijët më pak se 3 muaj

Çdo temperaturë që shfaqet në 3 muajt e parë të jetës duhet t'i komunikohet pедиатrit dhe të jetë objekt konsultimi, edhe nëse fëmija duket mirë.



Tek fëmijët mbi 3 muaj

Temperatura mbi 38°C

- Zhvishni fëmijën
- Jepini të pijë
- Mos e nxehti shumë dhomën (18/20°C)
- Prisni 30 minuta, pastaj ose :
 - o Gjendje e përgjithshme e mirë dhe temperatura më pak se 39°C → **kontrollojeni dhe konsultohuni, nëse nuk ka përmirësim**
 - o Gjendje e përgjithshme e keqe dhe/ ose temperatura 39,0°C ose më shumë → jepini një bar kundër temperaturës, mundësisht atë të përshkruar nga pediatri juaj dhe në përshtatje me moshën e fëmijës → **kontrollojeni dhe konsultohuni, nëse nuk ka përmirësim**

E rëndësishme

Fëmija juaj është i sëmurë, telefononi :

1. Pediatrën tuaj
2. Qendrën e mjekëve : 0848 133 133
3. Në rast urgjence jetike : 144



Programme cantonal de promotion de la santé et de prévention primaire enfants (0-4 ans) - parents



Section VD No Ju
Fédération Suisse de Sages-femmes

